

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore për prokurorët e të gjitha niveleve;

Duke mbajtur parasysh rolin kyç të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës,

Në vlerësim të raportit të paraqitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për veprimtarinë e tij për vitin 2024, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij, konstaton:

Zhvillimin nga Këshilli të 38 seancave plenare dhe nxjerrjen e 300 vendimeve, përfshi edhe miratimin e ndryshimit të 5 akteve nënligjore, me qëllim mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë në tërësi, rritjes së performancës të trupës së prokurorëve dhe promovimit të tyre, bazuar në integritet, profesionalizëm dhe meritokraci.

Përditësimin dhe konsolidimin e databazës elektronike nga KLP-ja për gjendjen reale të burimeve njerëzore, në funksion të garantimit të funksionalitetit të zyrave të prokurorive përballë vakancave të shumta të krijuara nga procesi i vetingut dhe lëvizjet në sistem gjatë vitit 2024.

Realizimin e ndryshimeve në rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, në funksion të përmirësimit të efikasitetit dhe thjeshtimit të procedurave të vlerësimit.

Fillimin e procesit të bllokuar të vlerësimit etik dhe profesional me miratimin e 9 raporteve të para, ku përfshihet 1 raport vlerësimi për drejtues, 1 raport vlerësimi të përsheptuar dhe 7 raporte vlerësimi periodik.

Realizimin e procesit të verifikimit të kushteve ligjore për pranimin e kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024–2025 dhe përcaktimin e kuotës prej 25 kandidatësh për profilin prokuror.

Zhvillimin e procesit të verifikimit të pasurisë, figurës dhe kushteve të tjera ligjore për 23 kandidatë të diplomuar në profilin prokuror nga Shkolla e Magjistraturës përmes miratimit të vendimeve individuale dhe listës përfundimtare të kandidatëve për kandidim për emërim si prokurorë.

Miratimin e transferimeve me pëlqim me prioritet për të adresuar mangësitë në burimet njerëzore në disa prokurori.

Realizimin e procedurave për ngritje në detyrë për 3 prokurorë në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Realizimin në kohë të të gjitha procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve nga ana e Këshillit për plotësimin e 3 vakancave të fundit për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme.

Trajtimin e çështjeve nga KLP-ja të paraqitura nga ILD-ja për procesin e llogaridhënies së prokurorëve. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 3 procedura disiplinore të paraqitura nga ILD-ja duke përmbyllur një procedurë me vendim përfundimtar, dy procedura disiplinore pa një vendim përfundimtar për shkak të shkarkimit nga procesi i vetingut dhe humbjes së statusit të magjistratit dhe lënë 1 procedurë disiplinore në proces trajtimi për vitin në vazhdim.

Përmirësimin e komunikimit institucional përmes faqes *online* dhe rritjes së komunikimit me median.

Nisjen e procesit për hartimin e Strategjisë së Komunikimit me Median dhe caktimin e një anëtarë të posaçëm përgjegjës për marrëdhëniet me median.

Zhvillimin e mbledhjes së përbashkët vjetore në kuadër të bashkëpunimit me KLGJ-në dhe miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një prokuror dhe një gjyqtar janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore”.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2025, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të zhvillojë brenda vitit 2025 një analizë mbi reflektimet ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportet e BE-së për sistemin e drejtësisë dhe posaçërisht për punën e KLP-së, si dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në angazhimet e marra nga shteti shqiptar në kuadrin e procesit të negociatave për anëtarësim në BE.

2. Të reflektojë mbi rekomandimet e BE-së për vlerësimin dhe miratimin e mekanizmave garantues për unifikimin e standardeve dhe kritereve të përzgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë me ato të magjistratëve të Këshillit për të siguruar një nivel më të lartë transparence dhe konkurrencë të drejtpërdrejtë dhe përfundimet përkatëse t’ia bëjë të njohura Kuvendit brenda muajit dhjetor 2025.

3. Të vijojë angazhimin aktiv për përmbushjen me efektivitet të angazhimeve institucionale, lidhur me detyrimet në kuadër të raportimeve gjatë procesit të negociatave për anëtarësimin në BE.

4. Të përmbyllë miratimin e të gjitha akteve nënligjore të mbetura në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi brenda vitit 2025.

5. Të konsiderojë prioritet të punës së tij rritjen e përgjegjshmërisë, angazhimit dhe eficiencës së punës të anëtarëve dhe stafit të Këshillit për të ndryshuar situatën lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, duke rritur ndjeshëm numrin e raporteve analitike të vlerësimit për vitin në vazhdim. Lidhur me përmbushjen e kësaj përgjegjësie ligjore, të informojë Kuvendin me një raport të veçantë për këtë gjë në muajin dhjetor 2025.

6. Të zhvillojë një analizë të dedikuar të Këshillit për situatën aktuale dhe përcaktimin e masave të mundshme për plotësimin e vakancave të përkohshme dhe të përhershme të prokurorëve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm përfshi edhe miratimin e masave për efikasitetin e shpërndarjes së barabartë të ngarkesës për prokuroritë në të gjitha nivelet.

7. Të hartojë në bashkëpunim edhe me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm metodologjinë lidhur me strategjinë dhe masat konkrete që do të ndërmerren për të zvogëluar stokun e prapambetur të çështjeve në hetim në të gjitha nivelet (mbështetur edhe në përvojën e KLGJ-së) dhe për këtë të informohet Kuvendi brenda muajit nëntor.

8. Të intensifikojë masat për procesin e digjitalizimit të arkivave të sistemit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm për ruajtjen, sistemimin dhe digjitalizimin e arkivave të sistemit të prokurorisë në tërësi.

9. Të vijojë bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, duke i propozuar brenda muajit nëntor 2025 vlerësimin e Këshillit për inspektimet tematike për vitin në vazhdim, trajtimin në kohë të çështjeve disiplinore dhe komandimin e inspektorëve magjistratë pranë ILD-së.

10. Të forcojë bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për emërimet, formimin fillestar dhe atë vazhdues të prokurorëve, përfshirë përmirësimin e përmbajtjes së kurikulave të trajnimeve sipas nevojave të sistemit.

11. Të miratojë rregullat dhe mekanizmat e domosdoshëm për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 30.10.2025.